



Të rinjtë europianë, në krizë të thellë papunësie
Bie mbështetja e serbëve për anëtarësimin në BE
Turqi, gjobiten "the Simpsons"...

EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr.13, Nëntor - Dhjetor 2012

Speciale

Odiseja e statusit kandidat për në BE vazhdon... edhe vitin tjetër



Fatkeqësisht për qytetarët që duan të shohin progres me reformat dhe integrimin e Shqipërisë në BE, duket se kjo Odise e mirëfilltë për marrjen e statusit kandidat, e nisur që në qershor të vitit 2009, do të njohë episode dhe aventura të reja.

Pas përjetimit të një momenti optimizmi në tetor 2012, kur

Komisioni Europian i rekomandoi Këshillit të Ministrave të BE-së dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë me kushte kryesore miratimin e ligjit të Shërbimit Civil, ligjit për Gjykatën e Lartë dhe ndryshimit të Rregullores së Kuvendit, zhgënjimi ka kapluar sërish jetën publike.

...vijon në faqen 2 >>

Quo Vadis Kosova?



Albin Kurti, Lider i Lëvizjes Vetëvendosje dhe Vlora Çitaku, Ministre e Integritimit Europian, shprehen mbi bisedimet Beograd - Prishtinë

Për Çitakun: "Këto bisedime do të shërbejnë për përmirësimin e pozitës së qytetarëve të Kosovës duke respektuar sovranitetin dhe integritetin territorial reciprok."

Ndërsa për Kurtin: "Pjesëmarrja e Kosovës në këto bisedime i ka shërbyer Serbisë për ta rregulluar imazhin e saj karshi bashkësisë ndërkombëtare si një vend bashkëpunues e miqësor. Qëllimi i këtyre bisedimeve qysh nga fillimi ka qenë gjetja e një modaliteti që mundëson integrimin e Serbisë në BE pa e njohur Kosovën si shtet. Çelësi i shtetit të Kosovës është tek konsolidimi e fuqizimi i brendshëm dhe jo tek negociatat me jashtë për brendësinë e territorit".

...vijon në faqen 4 >>

Shqipëria, ende larg një politike kohezioni të mirëfilltë dhe plotësimit të kërkesave të IPA-s



EMA risjell në vëmendje politikën e zhvillimit rajonal duke evidentuar se Shqipëria nuk ka ende një politikë të mirëfilltë kohezioni dhe përgatitja e saj në kontekstin e aderimit në BE është akoma në një fazë shumë të hershme. Deri më tani, çështjet e zhvillimit rajonal janë trajtuar në nivel kombëtar përmes praktikës tradicionale të qeverisjes hierarkike. Në kontrast me këtë, përvoja e shteteve të reja anëtare nga Europa Qendrore ka treguar se suksesi i politikës strukturore dhe asaj të kohezionit në pjesën më të madhe

...vijon në faqen 3 >>

Odiseja e statusit kandidat për në BE vazhdon... edhe vitin tjetër

...vijon nga faqja 1 >>



Disa zhvillime pozitive gjatë vitit të fundit si marrëveshja e nëntorit mes PD dhe PS, e pasuar me miratimin e disa ligjeve që kërkonin shumicë të cilësuar, ndryshimet në kodin zgjedhor apo kufizimi i imuniteteve, e shtynë Komisionin Europian – nga ana e tij i predispozuar më shumë se kurrë t'i jepte një nxitje vendit tonë – të rekomandonte dhënien e statusit. Madje Komisioneri për Zgjerimin Fyle shkoi deri aty sa të pohonte pak javë më parë se KE – ja nuk është përpjekur me asnjë vend tjetër sa është përpjekur të ndihmojë Shqipërinë dhe se vendi ishte shumë pranë marrjes së statusit të vendit kandidat kësaj radhe.

Por tashmë, pas mbledhjes së Këshillit të Ministrave të BE-së në fillim të dhjetorit, mbledhje e cila nuk dha asnjë sinjal pozitiv për Shqipërinë, duket edhe më qartë se koha në dispozicion në vjeshtë u keqpërdor nga palët, sërish të paafta për të bërë kompromis dhe ndërtuar një dialog politik konstruktiv në të mirë të vendit.

Dështimit të liderëve politikë në gjetjen e një kompromisi dhe miratimin e tre ligjeve të lartpërmendura, iu shtua disi në sfond, por tashmë haptazi dhe qëndrimi kundërshtues i disa vendeve anëtare të BE-së. Përtej mohimeve të qeverisë shqiptare, tashmë nuk është aspak sekret se vende të rëndësishme në gjirin e BE-së si Holanda apo Gjermania nuk janë të kënaqura me progresin e Shqipërisë në fusha si luftimi i korrupsionit, mirëfunksionimi i sistemit të drejtësisë, në veçanti gjykimi i rasteve që përfshijnë funksionarë të lartë, etj. Me fjalë të tjera, as miratimi i tre ligjeve nuk do

të kishte mjaftuar të bindte Këshillin e Ministrave të BE-së t'i akordonte Shqipërisë statusin e vendit kandidat.

Përtej propagandës qeveritare optimiste, në fillim të vjeshtës, Lëvizja Europiane kishte paralajmëruar që marrja e statusit kandidat nuk do të ishte një hap kaq i sigurt dhe i thjeshtë. Në fakt, skenari më realist dukej një status i kushtëzuar, duke cituar kushtet për vijimësinë e procesit, si zbatimi i reformës zgjedhore, vijimi i dialogut politik, reformës në drejtësi dhe lufta kundër korrupsionit e krimit të organizuar. Ajo që ishte vërtetë e paparashikueshme, ishte komplikimi i mëtejshëm i situatës përmes deklaratash anakronike nacionaliste, të cilat tashmë kanë shkaktuar dhe reagimin negativ të Brukselit, duke iu shtuar listës së gjatë të problemeve që ka Shqipëria në rrugëtimin europian.

Tre vite e gjysmë pas aplikimit për anëtarësim në BE, Shqipëria ka shënuar një rekord negativ në vonesën për marrjen e statusit kandidat, duke u parakaluar nga vende fqinje të cilat e kishin nisur pas saj këtë rrugëtim.

Shpresat për marrjen e këtij statusi të vonuar, që në vetvete dhe i pashoqëruar me një datë për hapjen e negociatave përbën vetëm sinjalin formal të mosfundosjes së perspektivës europiane të vendit, do të përqendrohen në zhvillimet gjatë vitit 2013. Në një klimë politike të ashpërsuar dhe pa asnjë vullnet për progres me reformat, Shqipëria po shkon drejt zgjedhjeve të përgjithshme në qershor 2013.

Duke pasur parasysh se në çfarë mase zgjedhjet përthithin energjitë e partive, administratës publike dhe gjithë shoqërisë në tërësi, do të ishte jorealiste pritja e ndonjë mrekullie në përmbushjen e 12 rekomandimeve. Përpos kësaj, përgatitja, organizimi dhe përfundimi me sukses i procesit zgjedhor ka rëndësi të veçantë. Kjo jo vetëm për shkak të parregullsive të vërejtura vitet e mëparshme por edhe sepse prek drejtpërdrejtë një sërë prioritetesh të tjera si: dialogu politik, funksionimi dhe pavarësia e sistemit gjyqësor, profesionalizmi i administratës publike, etj.



Suksesi në realizimin e zgjedhjeve së bashku me progresin e reformave që ndihmojnë funksionimin dhe ruajtjen e pavarësisë së institucioneve, do të ishte konfirmim i pjekurisë politike dhe institucionale të arritur nga Shqipëria dhe arritje e merituar e statusit të vendit kandidat për anëtarësim në BE. Në vjeshtën e 2013-ës, ndoshta.

Stafi i EuroSpeak, dhjetor 2012

Shqipëria, ende larg një politike kohezioni të mirëfilltë dhe plotësisht të kërkesave të IPA-s

...vijon nga faqja 1 >>

varet nga funksionimi i llojit të qeverisjes shumë-nivelesh dhe shumë-aktorësh. Për rrjedhojë, aplikimi i konceptit të qeverisjes shumë-nivelesh është një praktikë e mirë për të nxjerrë mësim të vlefshme, për përballimin e sfidave të përafrit me politikën e kohezionit të BE – së dhe në përputhje me kërkesat e komponentit IPA III mbi Zhvillimin Rajonal.

Lidhur me “parimin e partneritetit”, në fazën ku ndodhet Shqipëria është e rëndësishme të merren në konsideratë:

Institucionalizimi i partneritetit.

Kuadri legjislativ i zhvillimit rajonal kërkon riformulim të konsiderueshëm të politikës, si dhe modifikime institucionale në mënyrë që gradualisht të konvergojnë politikën e zhvillimit rajonal dhe institucionet përkatëse me politikën e kohezionit të BE-së dhe me kërkesat IPA, të paktën në terma kohorë afat mesëm.

Rritje të kapaciteteve dhe mirë-koordinim midis aktorëve.

Kapacitetet e dobëta administrative dhe mungesa e koordinimit midis aktorëve përkethehet në projekte jo të përshtatshme dhe thithjen e ulët të fondeve të BE-së. Kështu, ndërtimi i mëtejshëm i kapaciteteve të partnerëve përmes trajnimeve dhe asistencës teknike, është i nevojshëm për ngritjen e një bazë të mirë të një partneriteti të suksesshëm dhe funksional në të ardhmen. Shembulli sllovak i programeve të rekrutimit intensiv në të gjitha ministrinë përkatëse dhe pagesat konkurruese të punonjësve që merren me axhendën e integritimit

europian është një praktikë e mirë për të krijuar dhe ruajtur një staf të kualifikuar dhe të përshtatshëm.

Ndarja e qartë e përgjegjësisë midis aktorëve.

Ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësisë duhet të shprehet në kuadrin ligjor dhe atë të politikave, si dhe të nxitet nëpërmjet aplikimit të rasteve konkrete të praktikave të partneritetit. Në rastin e Shqipërisë ku ekzistenca e kuadrit ligjor jo domosdoshmërisht do të çojë në përfshirjen aktive në partneritet të aktorëve, disa veprime para-përfshirëse, nëpërmjet dialogut dhe konsultimeve të zgjeruara, janë të nevojshme në mënyrë që të forcohet kultura e partneritetit nëpërmjet “të mësuarit duke vepruar”.



Modelet e procesit të partneritetit varen nga specifikat dhe nevojat e vendit. Duke u nisur nga fakti se Shqipëria ka kapacitete të kufizuara, është logjike që aktorët publikë të kërkojnë dhe inkurajojnë bashkëpunimin me aktorë të organizatave jo-qeveritare dhe të ndajnë apo të zhvendosin ngarkesën duke bashkuar burimet dhe deleguar detyra të zbatimit. Nga ana tjetër, OJQ-të dhe aktorët e tjerë privatë mund të shkëmbejnë burimet dhe ekspertizën e tyre në funksion të një ndikimi mbi politikën dhe projektet të cilat do të prekin dukshëm ata, si dhe ta bëjnë procesin më transparent, efikas, gjithëpërfshirës dhe legjitim. Megjithatë, partneriteti i formalizuar është vetëm një hap, por jo një garanci për zbatimin e parimit të partneritetit. Ndaj ajo që nevojitet është ndërveprimi i rregullt midis palëve të interesuara publike, jo-qeveritare dhe private, i cili do të gjenerojë besim dhe do të nxisë partneritet të vërtetë.

Stafi i EuroSpeak, nëntor 2012



Quo Vadis Kosova?

...vijon nga faqja 1 >>

Intervistë me znj. Vlora Çitaku, Ministre e Integritit European e Kosovës

EuroSpeak: E nderuar Znj. Çitaku, sa të frytshme i konsideroni deri më tani bisedimet Beograd – Prishtinë?

Vlora Çitaku: Qëllimi kryesor i bisedimeve Kosovë-Serbi është normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve të pavarura në funksion të zhvillimit të marrëdhënieve të mira fqinjësore si me të gjitha shtetet tjera me të cilat Kosova kufizohet. Ne e kemi të qartë që Serbinë do të vazhdojmë ta kemi fqinjë në të ardhmen dhe besojmë se këto bisedime do të shërbejnë për përmirësimin e pozitës së qytetarëve tanë duke respektuar sovranitetin dhe integritetin territorial reciprok.



EuroSpeak: Në veçanti, si do ta vlerësonit nivelin e zbatimit të marrëveshjeve të arritura nga ana e Serbisë deri më tani?

Vlora Çitaku: Fatkeqësisht Serbia ka treguar që nuk është aq e gatshme të hyjë në dialog në radhë të parë pa një presion direkt dhe të qartë nga BE – ja dhe vendet anëtare të saj. Sa i përket implementimit të marrëveshjeve, ne nuk jemi shumë të kënaqur dhe presim përkushtim më të madh nga Serbia në harmoni me obligimet të cilat i kanë marrë. Serbia duhet të tregojë rezultate konkrete në shuarjen e strukturave paralele në Kosovë, ndalimin e financimit klandestin të këtyre strukturave, të jetë konstruktive në menaxhimin e integruar të kufirit, t'i përmbahet rregullave të komunitetit energjetik, etj.

EuroSpeak: Një pjesë e opinionit publik në Kosovë i kundërshton bisedimet Beograd – Prishtinë dhe është i mendimit se Kosova nuk po del e fituar prej tyre. Cilat janë objektivat e qeverisë së Kosovës në

të ardhmen e afërt lidhur me këto bisedime? Çfarë synoni të arrini konkretisht nga Serbia në drejtim të njohjes së pavarësisë së Kosovës?

Vlora Çitaku: Qëllimi kryesor i këtij dialogu është pranimi përfundimtar i shtetit të Kosovës nga ana e Serbisë. Ne e kuptojmë që Serbia ka probleme me njohje direkte, por të gjithë hapat që jemi duke i marrë në procesin e dialogut çojnë drejt njohjes së Kosovës. Kosova kurrësi nuk mund të dalë e humbur këtu. Me marrëveshjen për menaxhimin e integruar të kufirit ne kemi shënuar vijën kufitare të Kosovës e cila është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe vullnetin e qytetarëve tanë. Ne presim që të shuhet të gjitha strukturat paralele dhe të punojmë në funksionalizimin e strukturave legjitime të cilat do të dalin nga vullneti i qytetarëve të Kosovës.



Kjo do të ndikojë në përmirësimin e pozicionit të Kosovës dhe Serbisë karshinjera – tjetrës, por edhe në procesin e integritimeve europiane.

Intervistë me z. Albin Kurti, Lider i Lëvizjes Vetëvendosje

EuroSpeak: I nderuar Z. Kurti, siç e dimë, Lëvizja Vetëvendosje i ka kritikuar që në zanafillë bisedimet Beograd – Prishtinë. Por cili është qëndrimi juaj në lidhje me marrëveshjet e fundit të arritura dhe me zbatimin e marrëveshjeve në tërësi deri më sot?

Albin Kurti: Bisedimet midis Kosovës dhe Serbisë janë të padrejta sepse nuk janë bisedime midis të barabartësh. Ato janë të dëmshme sepse objekt negociatash janë çështjet që çenojnë drejtpërdrejt aspekte të ndryshme të shtetësisë së Kosovës.

Serbia nuk e njeh Kosovën si shtet, por as nuk i fsheh ambiciet e saj hegjemoniste ndaj Kosovës, qoftë në nivel diplomatik duke lobuar kundër njohjes së Kosovës, por edhe në rrafshin e brendshëm territorial, duke financuar e mbajtur struktura ile-



gale që minojnë rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.

Këto bisedime qysh nga i ashtuquajtimi “dialog teknik” kanë nisur si nevojë e lehtësimit të rrugës së Serbisë drejt integritit në Bashkimin Europian. Ato janë inicuar nga Serbia, por edhe dinamika e zhvillimit të tyre varej nga zhvillimet në Serbi. **Pjesëmarrja e Kosovës në këto bisedime i ka shërbyer Serbisë për ta rregulluar imazhin e saj karshi bashkësisë ndërkombëtare si një vend bashkëpunues e miqësor. Qëllimi i këtyre bisedimeve qysh nga fillimi ka qenë gjetja e një modaliteti që mundëson integritin e Serbisë në BE pa e njohur Kosovën si shtet. Një zgjidhje e tillë është e mundur vetëm me një Kosovë pa qëndrim subjektiv, që nuk kushtëzon dialogun me njohjen e saj si shtet, njohje kjo që do të mundësonte një dialog të mirëfilltë në të ardhmen.**

Prandaj, ne në Lëvizjen VETËVENDOSJE! nuk gjykojmë në terma të efikasitetit sepse kjo nënkupton miratimin e heshtur të rrugës që po ndiqet dhe projektit që po zbatohet. Ne nuk gjykojmë zbatimin e marrëveshjeve të arritura pa i gjykuar vetë marrëveshjet njëherë.

EuroSpeak: Cilat gjykoni se kanë qenë lëshimet/kompromiset më të mëdha nga pala kosovare dhe çfarë pasojash lënë ato në përpjekjet për konsolidimin e Kosovës si shtet i pavarur dhe për njohjen nga Serbia apo vende të tjera?

Albin Kurti: Në fakt, vetë shteti i Kosovës është i ndërtuar mbi kompromise. Është Plani i Ahtisaarit themeli i dobët i shtetit të Kosovës, projekti që atëhere quhej “kompromis i dhimbshëm” për të marrë edhe pranimin e Serbisë e kësaj të mos kishim pengesa në OKB nga Rusia. Por fakti është që Kosova e mori përsipër dhe e zbatoi këtë plan në mënyrë të njëanshme, ndërkaq Serbia nuk lëvizi nga pozicioni i saj fillestar. Sot ndodhemi në situatën kur kompromisi i negociatave të kaluara, është pozicioni ynë fillestar për negociatat e ardhshme.

Të gjitha marrëveshjet e arritura për çështjet e ndryshme deri më tash presupozojnë marrëdhënien asimetrike midis Kosovës dhe Serbisë. Janë

pranuar targat KS sikur në kohën e UNMIK – ut kur Kosova administrohej nga rezoluta 1244, janë pranuar kopjet e regjistrave kadastralë duke ia lënë Serbisë origjinalet, është pranuar që kufiri midis Kosovës dhe Serbisë të quhet kufi administrativ, është pranuar gjithashtu që Kosova të paraqitet me fusnotë në takimet rajonale me mbishkrimin absurd “duke mos paragjykuar qëndrimin e palëve mbi statusin”. Kosova ka qenë e pushtuar nga Serbia. Ajo e ka shpallur pavarësinë e saj për tu shpëputur nga Serbia, andaj nëse ka ndonjë vend me të cilin Kosova duhet t’i ketë të përcaktuara marrëdhëniet në mënyrë fare të qartë strikte e formale, pa lënë vend as për keqkuptimin më të vogël, ky vend është Serbia.

Gjithsesi, përpjekjet e Kosovës drejt shtet-ndërtimit nuk duhet të përqendrohen në bindjen dhe pajtimin e Serbisë me shtetin e Kosovës. Asnjë vend dhe as Kosova nuk do të çlirohej po të priste për lejen e pushtuesit. Pra, çelësi i shtetit të Kosovës është tek konsolidimi e fuqizimi i brendshëm dhe jo tek negociatat me jashtë për brendësinë e territorit.

EuroSpeak: Duke pasur parasysh rëndësinë e një vendi si Serbia në rajon, ndërtimi i një marrëdhënieje fqinjësie të mirë është i domosdoshëm. Duke u nisur nga ky këndvështrim, cila do të ishte rruga konkrete për përmirësimin e marrëdhënieve Kosovë – Serbi në të ardhmen e afërt?

Albin Kurti: Fqinjësia e mirë do të jetë e mundur vetëm kur do të ndërtohet mbi themele të shëndosha. Këto themele të shëndosha janë themelet e barazisë. Shikuar historikisht, ne nuk kemi qenë asnjëherë të përfshirë në ndërmarrje agresioni ndaj territorit apo popullit serb. Përkundrazi, luftërat tona kanë qenë çlirimtare nga shovinizmi serb. Andaj, është Serbia ajo që duhet të ndryshojë për ta bërë të mundur një gjë të tillë. Të thuash siç thuhet sot në qarqe të ndryshme ndërkombëtare se për arrijtjen e fqinjësisë së mirë duhet të ndryshojnë edhe Kosova edhe Serbia, kjo i bie se ne duhet të pranojmë se kemi faj edhe për të kaluarën e përgjakshme që e ka shkaktuar Serbia.

Stafi i EuroSpeak, dhjetor 2012



Kartolina nga BE-ja

Të rinjtë europianë, në krizë të thellë papunësie

Papunësia mes të rinjve ka qenë gjithmonë më e lartë se papunësia e përgjithshme, por kriza ekonomike e ka zgjeruar më tej hendekun. Sipas Eurostat, 22% e 15-24 vjeçarëve në BE janë të papunë. Në vendet e prekura më rëndë nga kriza, të tilla si Greqia dhe Spanja, shifra arrin në 50%.



Një tregues shumë i saktë i krizës së punësimit të të rinjve është koncepti NEET (not

in education, employment, or training) - numri i përgjithshëm i të rinjve që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim. Vitin e kaluar, Europa kishte 7.500.000 NEET të moshës 15-24 vjeç. NEET i kushtojnë vendeve të BE-së 153 bilionë euro në terma përfitimesh sociale dhe prodhim të humbur në vitin 2011. Disa ekonomistë tashmë flasin për një "brez të humbur".

Çfarë duhet të bëhet për të ndihmuar të rinjtë të gjejnë punë?

Një edukim i mirë është në shumë raste sigurimi më i mirë kundër papunësisë. Në Francë, për shembull, mbi 80 % e atyre me një diplomë universitare kanë një punë, por vetëm 55% e atyre me arsim bazë punësohen. Por një diplomë universiteti nuk është gjithnjë garanci për punë: në Spanjë studentët luftojnë akoma më shumë për të gjetur një punë, pavarësisht diplomave. Vendet me sistem të arsimit të dyfishtë të suksesshëm, që kombinojnë trajnimin në punë me shkollimin, priren të kenë norma të ulëta NEET. Gjermania, Austria dhe Holanda janë shembuj të mirë.

Suedia, Finlanda dhe Norvegjia janë pionerë të idesë së "garantimit të të rinjve". Shërbimet e punësimit përpunojnë nga një plan të personalizuar për çdo

të ri që është i paangazhuar dhe e përgatisin atë për arsimim, trajnim profesional ose një punë. Normat e ulëta të NEET në të gjitha vendet nordike sugjerojnë se këto programe po funksionojnë.

Rol të rëndësishëm luan fleksibiliteti i tregjeve të punës dhe rasti i Eurofund paraqet dëshmi që rregullat strikte, të tilla si ligjet e mbrojtjes së vendeve të punës, prekin më së shumti të rinjtë në kërkim. Së fundmi, nevojat e të rinjve nuk janë të përfaqësuara siç duhet në debate rreth ndryshimit të tregjeve të punës. Prandaj të rinjtë duhet të bashkohen në sindikata dhe të ngrenë zërin.

Stafi i EuroSpeak, dhjetor 2012

Shefat baballarë priren të rrisin rrogën e tyre... në dëm të punonjësve

Një studim i botuar në revistën e Shkencave Administrative analizon se çfarë ndodh me pagën e punonjësve kur shefi mashkull bëhet me fëmijë. Studimi është realizuar në Danimarkë dhe janë gjurmuar pagat në çdo firmë me më shumë se dhjetë të punësuar për periudhën 1996 – 2006. Sipas këtij studimi, rezulton se shefat meshkuj e paguajnë veten më shumë sapo bëhen baballarë. Nëse fëmija është një vajzë ata e paguajnë veten



me 3.5% më shumë sesa homologët e tyre pa fëmijë. Ndërsa kur fëmija është një djalë, paga e tyre rritet me 6.4%. Një nga autorët e studimit, David Ross i Columbia Business School, thotë se të gjithë etërit e ndjejnë si detyrë të mbështesin familjet e tyre, çka nënkupton

rritje të të ardhurave. Ky është një lajm i keq për vartësit pasi studimi evidenton se paratë shtesë vijnë nga punonjësit. Personeli i punësuar nga një baba zakonisht paguhet më pak. Janë punonjësit meshkuj që mbajnë barrën më të madhe, pasi nëse

fëmija i shefit është një djalë, pagesa e tyre ulet me 0.5% krahasuar me rastin kur shefi nuk do të kishte pasardhës. Stafi i gjinisë femërore është në pozitë më të mirë. Pas fëmijës së parë të shefit, ato mund të paguhen më shumë. Z. Ross spekulon se kjo vjen për shkak se duke parë sakrificën e bashkëshorteve të tyre, ata fillojnë t'i respektojnë më shumë gratë. Mirëpo entuziazmi ndërpritet sapo shefi bëhet me fëmijën e dytë. Në këtë rast pagat e punonjësve gra kanë të ngjarë të zvogëlohen.

The Economist, 24 nëntor 2012

Komisioni European parashikon dy ndryshime traktati për të arritur integrimin e plotë

Më 5 dhjetor, KE publikoi vizionin për një bashkim "të vërtetë" ekonomik dhe monetar, sipas të cilit buxheti qendror european do të lejojë transfertat për vendet me ekonomi të trazuar. Procesi do të kërkojë dy runde ndryshimi të traktatit, një brenda pesë viteve të ardhshme dhe një tjetër më i thellë në periudhë më afatgjatë.

Idetë për të ardhmen përfshijnë koordinimin e politikave kombëtare fiskale dhe të punësimit, euro-bonove, dhe të një buxheti të eurozonës i cili do të menaxhohet nga një zyrë thesari pranë KE - së.

Ndër të tjera, dokumenti i Komisionit kërkon që brenda 18 muajve të ardhshëm, BE - ja të mundësojë një bashkim bankar për të krijuar një "instrument të konvergencës dhe konkurrencës", i cili brenda 5 viteve të ardhshme do të shndërrohet në një buxhet të veçantë të eurozonës që do të financohet nga taksa të mbledhura vetëm për këtë qëllim. Publikimi, gjithashtu, kërkon emetimin e euro-bonove afatshkurtër dhe krijimin e një fondi për ri-blerje të euro-bonove të shteteve me borxh publik të lartë.

Duke vënë në dukje "shkallën" e sovranitetit që shtetet anëtare duhet t'i delegojnë Brukselit, publikimi sugjeron sigurimin e natyrës demokratike të këtij procesi nëpërmjet përfshirjes së Parlamentit European.

EU Observer, 28 nëntor 2012

Bullgarët kërkojnë të drejtën të pijnë duhan lirshëm

Sipas një studimi të fundit, në vendet europiane, çdo vit 270.000 persona diagnostikohen me kancer si pasojë e pirjes së duhanit. Informacioni u mbledh nga më shumë se 440.000 banorë të Danimarkës, Francës, Gjermanisë, Greqisë, Holandës, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar, Norvegjisë, Spanjës, dhe Suedisë.

Duhanpirësit aktualë kanë 2.6 herë më shumë rrezik tu zhvillohet një tumor i shkaktuar nga duhanpirja, ndërkohë që ish-duhanpirësit kanë 1.5 herë rrezik. Më shumë se 80% e tumoreve në mushkëri dhe laring shkaktohen nga pirja e duhanit. Ndërkohë që duhani është shkak dhe për 25% të kancerit në qafën e mitrës, stomak dhe pankreas.

Bullgaria renditet ndër pesë vendet kryesore europiane për shkallën e lartë të duhanpirjes. Është paradoksal fakti që pas këtij studimi bullgarët këmbëngulin dhe protestojnë për "të drejtën e tyre e të pirit duhan lirshëm". Protestuesit pro-duhanit u mbledhën përpara disa javësh para parlamentit bullgar në Sofje duke mbajtur parulla ku lexohej



"Të drejta të barabarta për duhanpirësit dhe jo duhanpirësit". Ata kërkuan shfuqizimin e ndalimit të pjesshëm që i detyron qendrat e mikpritjes të ndahen në zona të veçanta për duhanpirësit dhe jo-duhanpirësit, dhe denoncuan thirrjet për ndalim të plotë për pirjen e duhanit në hapësirat publike të mbyllura. Tubimi u bashkë-organizua nga Shoqata Bullgare e Pronarëve të Hoteleve dhe Restoranteve. Ndërkohë, pronarët e bareve në Bullgari organizuan në shenjë simbolike "tavolina bosh" për të nxjerrë në pah efektin e ndalimit të duhanit për bizneset e tyre.

Stafi i EuroSpeak, dhjetor 2012



Në pritje të aderimit...

Europa është më shumë se shpëtimi i Euros!



Duke u ndodhur përballë një krize ekonomike, Europa po i kushton më tepër rëndësi vetes duke harruar kështu vendet e Ballkanit

Perëndimor. Deri më tani, negociatat e pranimit të Kroacisë në BE kanë përfunduar me sukses, Serbia është shpallur vend kandidat e Mali i Zi ka filluar negociatat për pranim. Gjithsesi situata në Ballkanin Perëndimor nuk është edhe aq e mirë sa duket. Janë disa çështje që kanë rritur skepticizmin për tu bërë pjesë e BE-së.

Së pari, BE – ja ka humbur besueshmërinë. Në vitin 2004 BE-ja pranoi 10 vende njëkohësisht, pavarësisht kriterëve të papërbushura. Më pas u vendos që nuk do të pranohet më asnjë vend i cili nuk i përmbush të gjitha kriteret. Favorizimi i dikurshëm, politikisht i motivuar është shndërruar sot në diskriminim politikisht të motivuar. Proçeset e integrimit janë zgjatur, shumë reforma kanë ngelur në vend dhe projektet në shuma shumëmiliardëshe nuk e kanë zhvilluar Ballkanin Perëndimor. Fakte të tilla vënë në dyshim profesionalizmin e Bashkimit Europian.

Së dyti, dhuna etnike është një element kyç në Ballkanin Perëndimor. BE – ja shpenzon miliona euro për misionet ushtarake dhe asaj që quajmë vendosja e shtetit të së drejtës: në Kosovë ka ndërhyrë nëpërmjet EULEX, ndërsa në Bosnjë Hercegovinë nëpërmjet Althea dhe EUPM. Ekzistojnë diskutime për mbylljen e Zyrës së Lartë të Kombeve të Bashkuara në Bosnjë Hercegovinë, por është e qartë që diçka e tillë është e perealizueshme, pasi konfliktet etnike mund të ndodhin sërish. Misione të tilla do të mund të përmyllen vetëm në rast se integrimi europian përparon aq shumë sa nëpërmjet negociatave të krijohen shtete të qëndrueshme të së drejtës.

Së treti, fakti që Ballkani Perëndimor përbëhet nga shtete të vogla, s’duhet të ndalojë BE – në për nis-

jen dhe përshpejtimin e negociatave. Integrimi sektorial është një mundësi për përshpejtimin e proçesit të integrimit: Një vend i interesuar për tu pranuar përshtat vetë përpara fillimit të negociatave për anëtarësim kuadrin ligjor të BE-së në fusha të caktuara, duke përmirësuar kështu edhe pozitat e tij në tregti dhe investime.

Një tjetër faktor i cili ndikon ka të bëjë me elitat politike në Ballkanin Perëndimor të cilat fokusohen në përfitimet vetjake. Ato janë kundër reformave pasi rrezikojnë statusin e tyre dhe gjithashtu janë kundër bashkëpunimeve me shtetet fqinje për shkak të nacionalizmit që i solli në pushtet. Pjesa më e madhe e këtyre partive politike drejtohet nga një lider i cili largohet nga detyra vetëm me vdekjen e tij. Prandaj rëndësi i duhet dhënë shoqërisë civile, pasi është ajo e cila duhet të sjellë një alternativë demokratike përkundërt elitës politike.

Projekti europian mund të ketë sukses vetëm nëse njerëzit e mbështesin atë emocionalisht. Kjo duhet të vlejë jo vetëm për popujt në vendet candidate, por edhe për ata të vendeve anëtare, prej të cilëve kërkohet edhe një kontribut financiar për Bashkimin e zgjeruar. Jo vetëm Euro duhet shpëtuar, por gjithashtu edhe projekti i paqes, Europa.

Përmbledhje e punimit me të njëjtin titull, i Josip Juratovic, anëtar i Bundestag-ut Gjerman, publikuar nga Friedrich Ebert Stiftung

Dënimi i ish kryeministrit Kroat Sanader. Si duhet të lexohet nga politikanët tanë?

Gjykata e Zagrebit dënoi ish kryeministrin kroat gjatë viteve 2003-2009, Ivo Sanader, me 10 vite burg si dhe një gjobë prej 5 milion eurosh.

Sanader është akuzuar për marrjen e gjysmë milioni euro ryshfet nga banka austriake “Hypo” në vitin 1994, duke favorizuar hyrjen e saj në tregun financiar kroat si dhe për një tjetër ryshfet prej 10 milion eurosh nga kompania hungareze e naftës “MOL”, me qëllim krijimin e një pozicioni dominues në raport me kompaninë kroate të naftës “INA” ku ajo ishte aksionere. Ndërkohë,

një tjetër aktakuzë për abuzim me detyrën është ngritur kundër tij. Ai akuzohet për krijimin e një fondi sekret për partinë e tij, Bashkimi Demokratik Kroat (HDZ) nga zhvatja e fitimeve prej kompanive në pronësi shtetërore dhe manipulimi i tenderëve publik.



Kroacia ka qenë nën presionin e BE – së për të ndjekur një linjë të ashpër ndaj korrupsionit dhe Brukseli e ka parë çështjen nga afër.

Ndaj, bazuar në arritjet në kuadër të adresimit të kësaj çështjeje dhe pasi ka mbyllur me sukses negociatat me BE-në, Kroacia pritet që në korrik të 2013 të jetë shteti i 28 anëtar i BE – së.

Rasti i Kroacisë risjell në vëmendje sfidën e Shqipërisë në trajektoren e saj drejt BE – së, duke dëshmuar se vullneti politik për zbatimin e standardeve demokratike është drita jeshile në procesin e integritimit evropian. Ky është shembulli tipik i funksionimit të ligjit dhe parimeve demokratike bazuar në pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor, si gur themeli për garantimin e një demokracie funksionale. Vendimi ndaj Sanaderit në Kroaci është një këmbanë që bie dhe për klasën politike shqiptare, e cila duhet të dëshmojë vullnet politik në luftën kundër korrupsionit duke ofruar rezultate konkrete në kuadër të transformimit demokratik të vendit.

Stafi EuroSpeak, nëntor 2012

Dështimi i EULEX-it në Kosovë

Në mesin e tetorit, Gjykata Europiane e Auditorëve ka publikuar një raport mjaft kritik mbi rezultatet

(jo) të arritura nga misioni i EULEX-it në Kosovë. Por sipas disa zërave jo zyrtarë dështimet janë më të mëdha se ato të publikuara. Raporti është diskutuar gjerësisht në media duke eksploruar rolin dhe rezultatet e EULEX-it, si misioni më i madh i vendosur nga BE-ja dhe sot si flamurmbajtëse e vërtetë e Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Përfundimi kryesor i Gjykatës është se aktivitetet këshilluese të EULEX-it janë treguar joefektive dhe nuk kanë prodhuar rezultate saktësisht ku ishte nevoja më akute.

Fillimisht, raporti lavdëron punën e EULEX-it për çështjet e doganave, përshkruar si një “sukses i madh”. Është e vërtetë që të ardhurat doganore u rritën me tarifa 32% në mes të 2007 dhe 2010, por gjatë të njëjtës periudhë importet u rritën pikërisht me të njëjtën përqindje.

Meqë të ardhurat doganore varen nga importet, kjo do të thotë se EULEX-i nuk e ka përkeqësuar e as përmirësuar shërbimin doganor. Ndërkohë



që administrata fiskale është shumë më pak efikase: një problem serioz, sepse buxheti nuk mund të vazhdojë të varet nga importet, por duhet gjendur një bazë më e gjerë në mbledhjen e taksave brenda kufijve të Kosovës. Duhet theksuar që të ardhurat publike nuk janë në rrezik vetëm kur paratë mbledhen, por edhe kur shpenzohen. Nëse Shërbimi Doganor i Kosovës çdo vit mbledh 700 milionë euro; zyrtarët shpenzojnë në prokurim më shumë (pothuajse 800 milion, sipas raportit). Sistemi i prokurimit në Kosovë është thellësisht i korruptuar dhe joefikas. Rezultati është se paratë e mbledhura në kufi, nën sytë vigjilent të EULEX-it, vidhen disa ditë më vonë në një proporcion që varion nga 10% në 90%. Sipas këtyre të dhënave vjen në mendje miti i përpjekjes së pashpresë të



Sizifit. Gabim strategjik nuk ka qenë zgjedhja mes shërbimeve doganore, por ndarja e forcave. Përqendrimi i burimeve duhej bërë në institucionet më të dobëta të Kosovës: në luftën kundër krimit, krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Po funksionet ekzekutive? Për fat të keq nuk janë përfshirë në raport, por vlen të përmendet arrestimi i guvernatorit të pafajshëm të Bankës Qendrore. Ky vendim ka dëmtuar pa motiv një ndër institucionet më të mira të Kosovës. Tregues i dështimit të këtyre dy viteve nga EULEX janë: mungesa e ndonjë hetimi serioz të dosjeve në lidhje me PTK (kompani kombëtare telekomunikacionit), AKP (privatizimi), KEK-ut (energja), kontrata të Ministrisë së Arsimit dhe të personazheve të shquar të elitës lokale si Ekrem Luka, etj. Dështimet shkojnë përgjithësisht në favor të kryeministrit Hashim Thaçi dhe bashkëpunëtorëve e tij, dhe pastaj në kurriz të Kosovës edhe Bashkimit European. Por ka më shumë. Tre vjet më parë, EULEX-i ka burgosur tre fermerë serbë nga Novo Brdo për krime lufte të kryera kundër shqiptarëve në vitin 1999. Arrestimet kanë marrë mbulim të gjerë mediatik, gjë që ka ndihmuar për të rivendosur imazhin e misionit në një kohë të vështirë. Mendohet se EULEX-i ka sjellë në dritë këto raste vetëm për të rivendosur një imazh fitimtar në mision. Sa serbë kriminelë lufte të cilët ende jetojnë në Kosovë janë arrestuar në dhjetë vitet e fundit? Asnjë. Do vazhdonin këta njerëz të jetojnë përsëri në fshatin e tyre, në paqe me fqinjët e tyre shqiptarë, nëse ata do ishin kriminelët e luftës?

Me pak fjalë, përveç përjashtimeve të vogla, linja e misionit të BE-së ka qenë ajo e shërbimit të dobishëm për Thaçin, i dobët me të fortët dhe i fortë me të dobët. Lëvizje e zgjuar ishte fushata mediatike ku fillimisht shfaqet fraza "EULEX-i nuk ka bërë asgjë kundër korrupsionit", dhe një pikëpyetje e madhe e kuqe e shoqëron, e ndjekur pastaj nga disa fakte dhe shifra që duhet të çojnë në refuzimin e deklaratës së mëparshme. Kjo fushatë nisi kur EULEX-i ishte në dijeni tashmë për konkluzionet e raportit dhe ishte duke e përgatitur terrenin për mbrojtje. Por në interes të kujt u lançua ky spot: Bashkimit European, sundimit të ligjit, apo EULEX-it? Kjo fushatë nuk ishte veçse keqpërdorim i parave publike.

Balcani Caucaso, 28 nëntor 2012

Bie mbështetja e serbëve për anëtarësimin në BE

Vetëm 47% e qytetarëve dëshirojnë që Serbia të anëtarësohet në BE!

Sipas një studimi të ri, të titulluar "Qytetarët e Serbisë mes BE-së, NATO-s dhe Ruisisë", realizuar nga Qendra e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCBP), vetëm 47% e qytetarëve dëshirojnë që Serbia të anëtarësohet në BE. Rënie kjo prej 2% që nga studimi i fundit i kryer në shtator. Ndërsa 35% e njerëzve kundërshtojnë procesin e integritit të Serbisë në BE, 18% e tyre thonë se janë të pavendosur mbi këtë çështje. Kundërshtarët më të fortë të BE-së në Serbi janë të rinjtë e moshës 18-29 vjeç, të cilët janë 41.5% kundër BE-së, dhe 40.9% pro.

Në prezantimin e studimit, drejtoresha e BCBP, Sonja Stojanovic, ka argumentuar rënien e entuziazmit pro-european dhe rritjen e euro-skepticizmit "si pasoja të kushtëzimit në përparimin e mëtejshëm drejt BE-së, si dhe të përgjigjeve të politikanëve kryesorë, prej të cilëve në muajin e kaluar janë dëgjuar vetëm deklarata negative kundrejt BE-së". Ajo vuri në dukje se numri më i madh i euro-skeptikëve janë qytetarët e Beogradit.

Ky studim gjithashtu ka monitoruar disa çështje të sigurisë, si qëndrimet e qytetarëve serbë ndaj statusit të Kosovës dhe çështja e anëtarësimit në NATO. 62% e të intervistuarve janë kundër njohjes së Kosovës nga Serbia, ndërsa 11% mund të ndryshojnë mendim nëse kjo njohje do të sillte anëtarësimin e Serbisë në BE. Gjithashtu, përqindja e popullsisë që mbështet anëtarësimin në NATO ka rënë, ku 65% qëndrojnë kundër dhe 14% pro.

Për sa i përket marrëdhënieve me jashtë, shumica e të anketuarve shohin Rusinë, Greqinë, Kinën, Japoninë dhe Italinë si miqtë më të mirë të Serbisë. Ndërsa SHBA-në, Gjermaninë, Shqipërinë, Britaninë dhe Kroacinë si kërcënimet më të mëdha.

Balkan Insight, 7 tetor 2012

Turqi, gjobiten "the Simpsons"...

Në Turqi, Bordi i Radios dhe Televizionit (RTÜK) ka gjobitur televizionin privat CNBC-E rreth 22.000 Euro për transmetimin e një episodi të filmit vizatimor "The Simpsons" (Simpsonët) ku



shfaqet Perëndia nën komandën e Djallit. Bordi tha se gjoba është vënë për shkak se CNBC-E “është tallur me Perëndinë, dhe ka inkurajuar të rinjtë që të ushtrojnë

dhunë duke paraqitur vrasjet si urdhra të Perëndisë dhe duke i inkurajuar ata të konsumojnë alkool në natën e Vitit të Ri”.

“Një nga personazhet keqpërdor besimin fetar të tjetrit për ta nxitur atë të kryejë një vrasje. Bibla digjet publikisht në një skenë, ndërsa Perëndia dhe Djalli janë paraqitur si qenie njerëzore. Në një tjetër skenë, Perëndia i shërben kafën Djallit, çka mund të konsiderohet si një ofendim për besimet fetare”. Këto argumente paraqiti raporti i Bordit për të shpjeguar motivet për vendosjen e gjobës.

“The Simpsons” është filmi vizatimor amerikan i transmetuar më gjatë në kohë.

Hürriyet Daily News, dhjetor 2012

Bosnje, një individ akuzohet për vjedhjen e një ure të tërë

Një gjykatë në Bërçko në verilindje të Bosnjës ka akuzuar një burrë, i njohur deri më tani vetëm si A.H, për vjedhjen e një ure të vogël metalike përgjatë lumit Zovicica në zonën Dizdarsa në Brcko. Njeriu vodhi urën metalike, që përdorej kryesisht për kalimin e traktorëve të fermave, dhe që ndodhej në një pronë private, duke e lidhur atë me traktorin e tij, dhe së bashku me disa ndihmës, e ka zvarritur gjer në shtëpinë e tij.

Raportet e mediave kanë sugjeruar se A.H e vodhi urën me qëllim që ta vendoste në tokën e tij. Ura peshonte disa ton dhe është përdorur prej vitesh nga familjet, kryesisht për të arritur fermat e tyre në anën tjetër të lumit dhe për të kryer punët bujqësore.

Sipas ligjit, burri duhet të paguaje një gjobë të rëndë ose të kryejë burgim gjer në tre vjet nëse shpallet fajtor.

Balkan Insight, 4 dhjetor 2012



Britania e Madhe jep numrin më të lartë të qytetarive në Europë



Në vitin 2010 mbi 810.000 individë morën shtetësinë europiane. Ndër kombësitë që emigrojnë për në BE, grupin më të madh e formojnë marokenët,

ndjekur nga turqit, ekuadorianët dhe indianët. Me 67.000 marokenë që ndryshojnë shtetësinë në vit, ata qëndrojnë në krye të listës së grupeve të huajve në Belgjikë, Francë, Itali dhe Holandë. Turqit (me 49.900 gjithsej) kanë prirje të shkojnë në Gjermani, duke përbërë kështu grupin më të madh që kërkon shtetësinë në këtë vend. Ekuadorianët priren të shkojnë në Spanjë dhe indianët në Britaninë e Madhe, duke reflektuar lidhjet historike, kulturore dhe të tregut të punës midis tyre.

Disa shtete anëtare të BE – së i japin shtetësinë kryesisht një kombësie të caktuar. 65% e qytetarëve të rinj të Hungarisë vijnë nga Rumania, ndërsa shqiptarët përbëjnë 65% të qytetarëve të rinj të Greqisë. Individët nga ish-Bashkimit Sovjetik - pa shtetësi të njohur - llogariten 96% dhe 91% e popullsisë në Letoni dhe Estoni. Nigerianët janë grupi më i madh që marrin shtetësinë në Irlandë, ndërsa portugezët në Luksemburg, australianët në Maltë, irakenët në Suedi dhe ukrainasit në Çeki si dhe Poloni.

Në aspektin e shifrave, Mbretëria e Madhe ka dhënë numrin më të madh të shtetësive në vitin 2010, konkretisht për 195.000 qytetarë të huaj, ndjekur nga Franca me 143.000, Spanja me 124.000 dhe Gjermania me 105.000 – të cilët në total përbëjnë 70% të shtetësive të dhëna në BE. Ndërsa në terma proporcionalë, Luksemburgu kryeson listën me dhënien e 4.300 shtetësive, çka do të thotë 8,6 shtetësi për 1000 banorë. Një shkallë më poshtë janë Suedia me 3.5% dhe Belgjika me 3.2%. Në 2010, në BE janë dhënë mesatarisht 1.6 shtetësi për 1,000 banorë.

Stafi EuroSpeak, nëntor 2012



Shoqëria shqiptare, ende thellësisht e pa-emancipuar lidhur me marrëdhëniet e mbrojtura



Kohët e fundit, një studim i USAID nxori në pah të dhëna mjaft shqetësuese lidhur me shëndetin riprodhues të grave në Shqipëri.

Konkretisht, rezulton se numri i aborteve është 230 aborte për 1.000 lindje, një shifër jashtëzakonisht e lartë krahasuar me mesataren europiane, 28 aborte në 1.000 lindje. Lajmi është veçanërisht shqetësues po të mendojmë se ndër arsyet kryesore që çojnë drejt këtyre aborteve renditen padituria lidhur me metodat kontraceptive, mos konsultimi i grave me mjekun, keqinformimi lidhur me efektet anësore të

medikamenteve kontraceptive si dhe presioni nga partneri për të përdorur metoda “tradicionale”. Përpos dëmit në shëndetin riprodhues të grave, mosndërgjegjësimi mbi rëndësinë e kryerjes së marrëdhënieve seksuale të mbrojtura, vjen me një kosto edhe më të lartë për shoqërinë: përhapja e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme vazhdon. Vetëm për 2012, janë diagnostikuar 70 raste të reja me HIV /AIDS, duke e çuar shifrën totale të rasteve të të prekurve nga HIV/AIDS në vendin tonë në 555. Transmetimi seksual mbetet rruga kryesore e transmetimit të infeksionit (93% e rasteve).

Ndërkohë që disa bëjnë çmos të anëtarësohen në BE, të tjerë nuk janë të interesuar...

Sipas sondazheve të kryera gjatë tre viteve të fundit, shumica e islandezëve kundërshtojnë anëtarësimin në BE dhe adoptimin e Euros, si dhe kërkojnë tërheqjen e aplikimit.

Stafi i EuroSpeak, dhjetor 2012

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritimit europian. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballet Shqipëria në rrugën drejt integritimit europian. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritimit europian. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave europiane si dhe i procesit të integritimit europian të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integritimit europian; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert, si dhe Programit Europe for Citizens të Komisionit Europian.



Të gjithë numrat e EuroSpeak i gjeni dhe në faqen e internetit të Lëvizjes Europiane në Shqipëri. Nëse dëshironi të merrni rregullisht buletin EuroSpeak nëpërmjet postës elektronike, na shkruani në: info@em-al.org.

Për komente ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren, Blerta Hoxha, në adresën: blerta.hoxha@em-al.org